



SHKOLLA E MESME E LARTË E MJEKËSISË “REZONANCA”

MEDICAL HIGH SCHOOL “REZONANCA”

Prishtinë

Nr.Prot. AD-1158/21

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT: Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë dhe Gjimnazi ”REZONANCA” shpall :

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në Klasën e X për vitin shkollor 2021-2022 në këto drejtime:

- | | |
|-------------------------------------|--------------------|
| 1. Infermieri e Përgjithshme | 150 nxënës. |
| 2. Teknik i dhëmbëve | 50 nxënës. |
| 3. Teknik i Farmacisë | 50 nxënës. |
| 4. Teknik i Fizioterapisë | 50 nxënës. |

Drejtimet e Gjimnazit:

- 1. Gjimnazi i Shkencave Natyrore 100 nxënës.**
- 2. Gjimnazi i shkencave Shoqërore 100 nxënës.**

- Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2021/2022, mund të konkurrojnë nxënësit të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ultë në komunën e Prishtinës si dhe në gjithë komunat e Republikës së Kosovës , të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

URL: <http://www.rezonanca-ks.com>

E-Mail: shmmrezonanca@gmail.com

shmm@rezonanca-rks.com

- Dokumentet e nevojshme për aplikim

Nxënësit për të aplikuar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë).

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9).

Certifikatën e lindjes.

- Afati i paraqitjes së dokumenteve

Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datën 09.06.2021 - 09.07.2021 në lokalet e shkollës së Mesme të Mjekësisë “Rezonanca”, adresa Rruga Magjistrale Prishtinë-Ferizaj km 10 , fshati Konjuh duke filluar nga ora 08:00-16:00.

Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes.

Përparësi kanë nxënësit e shkëlqyer.

Prishtinë

09.06.2021